

V E N D I M
Nr. 283, datë 27.6.2002

**PËR PËRCAKTIMIN E SHTRIRJES DHE TË NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË ZYRAVE
VENDORE TË AVOKATURËS SË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr. 8551, datë 18.11.1999 "Për Avokaturën e Shtetit", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Zyrat vendore të Avokaturës së Shtetit vendosen pranë gjykatave të apelit të Tiranës, Durrësit, Shkodrës, Vlorës, Gjirokastrës dhe Korçës.
 2. Prefektët e qarqeve: Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Gjirokastrë, Korçë t'u japin në përdorim, pa shpërblim, mjediset e nevojshme brenda prefekturës, avokatëve të zyrës vendore, përkatëse, të Avokaturës së Shtetit.
 3. Ngarkohen Avokatura e Përgjithshme e Shtetit dhe prefektët e qarqeve të lartpërmendura për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko